



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 1129/4 prot.

Tiranë më 31.7.2018

VENDIM

Nr. 45, datë 31.7.2018

PËR

RRËZIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Z. _____, në cilësinë e përfaqësuesit të Qendrës BIRN Albania, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 1129 Prot., datë 03.07.2018, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Me kërkesën e datës 19.06.2018 ankuesi ka kërkuar nga Autoriteti Publik t'i vihet në dispozicion dokumentacioni dhe informacioni i disponueshëm lidhur me dosjen hetimore të krijuar në vitin 2010 mbi gjetjen e varrit masiv 313 pranë fshatit Linzë në Dajt, dhe konkretisht: *Një kopje e dosjes bashkë me fotot e policisë shkencore mbi skenën e ngjarjes.*

Me shkresën nr. 3233/1 Prot., datë 02.07.2018 Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: "*Mbi bazën e materialit të referuar nga Drejtoria Vendore e Policisë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 2502, datë 24.06.2010 për veprën penale "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese, kundër dy ose më shumë personave", parashikuar nga neni 79/dh) i Kodit Penal. Me datë 15.12.2010 është vendosur pezullimi i hetimeve dhe për aq kohë sa nuk ka një vendimmarrje përfundimtare nga ana e Prokurorisë dhe se nga ana juaj nuk është provuar interesi i ligjshëm, aktet e fashikullit të këtij procedimi nuk mund të vihen në dispozicion".*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit ankimin nr. 1129 Prot., datë 03.07.2018 duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” në të cilin citohet se *“Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personalekur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”*, Komisioneri me shkresën nr. 1129/1 Prot., datë 06.07.2018 ftoi palët në një seancë dëgjimore.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 11038 Prot., datë 13.07.2018 bëri me dije Komisionerin se Prokurori përgjegjës për të Drejtën e Informimit, për shkak të ngarkesës administrative si drejtues i seksionit të Forcës së Posacme si dhe procedimeve penale me veprime të ngutshme hetimore, është në pamundësi objektive për të marrë pjesë në seancë.

Seanca dëgjimore u zhvillua me datë 17.07.2018 në mungesë të përfaqësuesve të Autoritetit Publik dhe në prani të ankuesit, i cili paraqiti pretendimet e tij duke rikonfirmuar qëndrimin e mbajtur në ankesë. Z. pretendon se: *“Refuzimi i dhënies së informacionit nuk është argumentuar nga Autoriteti Publik referuar kufizimeve që parashikon neni 17, pika 2, germa b), e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Synimi i hapjes së hetimeve në lidhje me gjetjen e varrit masiv në vitin 2010, ka qenë identifikimi i viktimave dhe zbardhja e rrethanave të zhdukjes apo ekzekutimit të tyre. Fakti që prokuroria nuk ka arritur të zbardhë të vërtetën dhe nuk ka rinisur përmes ndonjë veprimi hetimor të vijojë punën, i jep njohjes me praktikën hetimore të ndjekur nga prokuroria një rëndësi të veçantë për familjet e viktimave të komunizmit”*.

Me shkresën nr. 11221 Prot., datë 17.07.2018, Autoriteti Publik ka depozituar pranë Komisionerit pretendimet lidhur me ankimin e Z. duke argumentuar se: *“Procedimi i çështjes është pezulluar dhe bazuar në pikën 5 të nenit 326 të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, hetimi i pezulluar mund të rifillojë me vendim të prokurorit në momentin që është zbuluar autori i veprës penale. Në aspektin procedural, vendimi i pezullimit është një status i ngrirë i çështjes, çka do të thotë se çështja konsiderohet në hetim. Në këtë këndvështrim, zbatohen kufizimet e publikimit të akteve të përcaktuara në nenin 103 të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.”*

Në shqyrtimin e çështjes, krahas dispozitave të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” gjejmë zbatim edhe dispozitat e Ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar. Nga vlerësimi i dispozitave të zbtueshme në tërësi, Komisioneri konstaton se, ashtu siç është përmendur edhe në argumentet e paraqitura nga Autoriteti Publik, gjatë fazës së hetimeve paraprake publikimi i akteve që kanë lidhje me çështjen është i ndaluar. Në hierarkinë e ligjeve, Kodi i Procedurës Penale qëndron mbi Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, duke pasur në këtë mënyrë përparësi ndaj dispozitave të këtij të fundit. Gjithashtu, bazuar

në nenin 17, pika 2, gërma b) e Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", e drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë për parandalimin dhe ndjekjen e veprave penale. Parë në këtë këndvështrim dhe posaçërisht ndalimin e shprehur dhe specifik lidhur me momentin procedural të parashikuar nga neni 103 i Kodit të Procedurës Penale, Komisioneri e gjen argumentin e Autoritetit Publik lidhur me kufizimet e përcaktuara në legjislacionin e posaçëm, të bazuar nga ana ligjore.

Megjithatë, duke pasur parasysh faktin që e drejta e informimit është një e drejtë themelore e njeriut, dhe si e tillë është e pandashme, e patjetërsueshme dhe e padhunueshme; gjithashtu duke pasur parasysh specifikën e rastit në fjalë, ku më shumë sesa identifikimi i autorëve të veprës penale, qëllimi kryesor është identifikimi i viktimave dhe njohja e familjarëve me fatin e të afërmeve të ekzekutuar nga regjimi komunist, Komisioneri do t'i sugjeronte Autoritetit Publik, vlerësimin e mundësisë së vënies në dispozicion të ndonjë informacioni në dosje i cili nuk çënon hetimet, por nga ana tjetër ndihmon në përmbushjen e qëllimit kryesor në rastin në fjalë, që është ai i identifikimit të viktimave dhe njohjes së familjarëve me fatin e të afërmeve të tyre.

Në lidhje me ankesën e Z. kundër Autoritetit Publik "Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë", Komisioneri vlerëson se ankesa nuk mund të pranohet për shkak të kufizimeve ligjore të arsyetuara më sipër.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit",

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankimit nr. 1129 Prot., datë 03.07.2018 të Z. kundër Autoritetit Publik "Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë".
2. Kundër këtij vendimi, palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
3. Ky vendim u shpall sot në datë 31.7.2018.

